



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT 02. 08. 2023  
14-020/04 - 159139/23 më

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/15 qershor 2008) të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet vendimi për organizimin e ushtrimit praktik “ZJARRI 2023”.
2. Qëllimi i organizimit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është testimi i gatishmërisë reaguese të pjesëtarëve të personelit Komunal në objektin e vjetër të Komunës dhe qytetarëve që ndodhen në objekt në rast të zjarrit dhe fatkeqësive tjera natyrore, si dhe koordinimin e institucioneve për reagim në zjarre dhe fatkeqësi tjera natyrore për: shuarjen e zjarrit, kërkim shpëtimin, evakuimin e personelit dhe qytetarëve.
3. Ushtrimi organizohet në objektin e Komunës së vjetër sipas dinamikës së paraparë nga Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë me datë 03.08.2023, ku do të involvohen personeli përgjegjës për reagim në situata të tilla si dhe institucionet e sigurisë së Kryeqytetit.
4. Pjesëmarrës në ushtrimin praktik do të jenë:
  - Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë;
  - Drejtoria e Administratës;
  - Drejtoria e Shëndetësisë;
  - Drejtoria e Financave;
  - Policia e Kosovës;
  - Brigada Profesionale e Zjarrfikësve;
  - Qendra e Mjekësisë Urgjente;
  - Kryqi i Kuq Komunal;
5. Komandant i Incidentit për këtë ushtrim praktik caktohet Lulzim Fushtica – Drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë në Kryeqytet.
6. Për punën, organizimin dhe mbarëvajtjen e ushtrimit është përgjegjëse Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë dhe Brigada Profesionale e Zjarrfikësve.

7. Shpenzimet për organizmin e ushtrimit praktik i bartë Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**U DORËZOHET:**

- Pjesëmarrësve në ushtrim praktik;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
**Përparim Rama**

